



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:225394

Datë: 12.03.2024

Numri i dokumentit: 05442222

C.nr.576/17

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Jeton Zymeri, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.N nga Prishtina, Lagjja ..., rruga ..., të cilin e përfaqëson i autorizuari M.N avokat në Prishtinë rruga ... kundër të paditurit Xh.H nga ish fshati ... Komuna e Vushtrrisë, tani me adresë të panjohur në Prishtinë, me objekt kontesti Kompensim dëmi, me vlerë të kontestit 1,320.00 euro, jashtë seance me datë 12.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET E TËRHEQUR padia për kompensimin e dëmit, e datës 29.11.2017, e paditësit A.N nga Prishtina, Lagjja ..., rruga ... kundër të paditurit Xh.H nga ish fshati ... Komuna e Vushtrrisë, tani me adresë të panjohur në Prishtinë, për shkak të mosplotësimit të padisë me adresën e saktë të të paditurit.

A r s y e t i m

Paditësi A.N nga Prishtina, Lagjja ..., rruga ..., përmes të autorizuarit të tij, me datë 29.11.2017, ka parashtruar padi për kompensimin e dëmit, kundër të paditurit kundër të paditurit Xh.H nga ish fshati ... Komuna e Vushtrrisë, tani me adresë të panjohur në Prishtinë

Me aktvendimin e datës 09.02.2024, gjykata e ka ftuar paditësin që në afat prej 3 ditësh, të plotësoj padinë me adresën e saktë të palës së paditur, nën të kundërtën padia do të konsiderohet e tërhequr. Këtë aktvendim i autorizuari i paditësit e ka pranuar me datë 15.02.2024, por nuk e

ka vepruar sipas thirrjes së gjykatës, përkatësisht nuk e ka plotësuar padinë me adresën e saktë të të paditurit.

Andaj marr parasysh të lartcekurat, gjykata konform nenit 102 par.3 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C.nr.576/17, me datë 12.03.2024

Gj y q t a r i

Jeton Zymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.